



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës, më 04.02.2026

NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS
Mbledhje e Radhës

Në mbështetje të nenit 17, nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E MARTË, DATË 10.02.2026, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË RADHËS, NË SALLËN E KËSHILLIT BASHKIAK Durrës, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE, QË KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT, TË PASHPËRNDARA NË VITIN 2025, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2026
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 50, DATË 21.05.2024, “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË Durrës, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, TË PASURISË ME NR.101/2, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE 1664M ² , ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3541”
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 473320.05 (KATËRQIND E SHTATËDHJETË E TRE MIJË E TREQIND E NJËZETË PIKË ZERO PESË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE NË QYTET”, PËR RRUGËN “ÇEL ISLAMI”
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 867,776,164.65 (TETËQIND E GJASHTËDHJETË E SHTATË MILION E SHTATËQIND E SHTATËDHJETË E GJASHTË MIJË E NJËQIND E GJASHTËDHJETË E KATËR PIKË GJASHTËDHJETË E PESË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “LIDHJA E CURRILAVE ME RRUGËN “A.GOGA”
Pika 7. Raportim kryetari i KB	RAPORT PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR VITIN 2025
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimin do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, nenit 34 pika 1, nenit 77 pika 8, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin projektvendimin përkatës, dorëzojnë propozimin e tyre (Raportin) mbi projektvendimin pranë zyrës së Sekretarit të Këshillit, sipas grafikut të mëposhtëm.

Datë 09.02.2026

Nr.	Komisionet që shqyrtojnë projektvendimet	Projektvendime pikat e rendit të ditës	Vendi i mbajtjes së mbledhjes	Ora
1.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	1,2,3,4,5,6	Zyra Sekretarit të Këshillit	10.00

2.	Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike	2,3	Zyra Sekretarit të Këshillit	11.00
3.	Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	3	Salla e Këshillit	11.30
4.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	4, 5, 6	Salla e Këshillit	12.00
5.	Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	5, 6	Salla e Këshillit	13.00
6.	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit	1	Zyra Sekretarit të Këshillit	14.00

Pika 7. Raporton në mbledhjen plenare Kryetari i Këshillit.

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Dorina Milja